



Periodiku AMF

Miratohet në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, Ligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

Kuvendi i Shqipërisë, më datë 15 tetor 2009, miratoi në seancë plenare Ligjin “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shtator 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-shtator, arritën shifrën 6,169,406 mijë lekë përkundrejt 5,395,411 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 14.35% më shumë.

Vijon në faqen 2

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2009

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë 9-mujorit të vitit 2009 u dominua në masën 95.50% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 4.5% nga instrumente afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 5

Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar-shtator 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, por ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve.

Vijon në faqen 6

Ngjarje dhe zhvillime të tjera Zhvillohet Konferenca e 16-të Vjetore e IAIS

IAIS, (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime) në bashkëpunim me SUSEP (Institucioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Brazil), zhvilluan gjatë periudhës 21-24 tetor 2009, në Rio de Janeiro, Brazil, Konferencën e 16-të Vjetore me temë: “Sigurimet si mjet i zhvillimit social-ekonomik, kriza financiare dhe e ardhmja e tregjeve të sigurimit”.

Vijon në faqen 7

Zhvillohet Takimi i Përgjithshëm Vjetor i IOPS dhe forumi global i OECD/IOPS për pensionet private “Reforma e pensioneve dhe zhvillime në Amerikën Latine”

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me OECD, zhvilluan në Rio de Janeiro, Brazil gjatë periudhës 14-16 tetor 2009, takimet e mëposhtme:

a) Forumi global i OECD/IOPS për pensionet private “Reforma e pensioneve dhe zhvillime në Amerikën Latine”, 14-15 tetor 2009,

Vijon në faqen 11

E ardhmja e kuadrit rregullator financiar, roli i rregullores dhe enteve rregullatore të tregut

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), tetor 2009).

Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Letrave me Vlerë, zhvilloi në Bazel, Zvicër, gjatë periudhës 8-9 tetor 2009, Konferencën e 5-të

Vijon në faqen 13

Zhvillohet Konferenca X-NET: “Pjesëmarrje efektive në tregjet financiare botërore”

Bursa e Athinës, zhvilloi më 26 tetor 2009, Athinë, Konferencën X-NET: “Pjesëmarrje efektive në tregjet financiare botërore”

Vijon në faqen 15

Edukimi i konsumatorit Përmirësohen gjatë vitit 2009 asetet e fondeve të pensioneve të vendeve OECD, si dhe raportet e financimit të tyre

(Material i nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS), tetor 2009.)

Në gjysmën e parë të vitit 2009, sistemet e fondeve të kapitalizuara në vendet e OECD, janë rimëkëmbur më shumë se 1.5 miliard USD nga 5.4 miliard USD në vlerë tregu që ato humbën në 2008 (nga 27.8 miliard USD në dhjetor 2007 në 22.4 miliard USD në dhjetor 2008).

Vijon në faqen 18

Në këtë numër:

Miratohet në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, Ligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore” **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **7**

Edukimi i konsumatorit **18**



Miratohet në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, Ligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

Kuvendi i Shqipërisë, më datë 15 tetor 2009, miratoi në seancë plenare Ligjin “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

Ky ligj zbatohet për obligacionet e:

- a) shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë; dhe
- b) qeverisë vendore.

Qëllim i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore, zhvillimi i tregut të kapitaleve dhe mbrojtja e investitorëve. Ligji i obligacioneve u hartua edhe në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislacioni shqiptar në lidhje me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara “Ligji për Titujt” dhe “Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me qëllim që të arrihet përfshirja e ligjit të obligacioneve në mënyrë harmonike me ligjet në fjalë.

Struktura e ligjit aktual është në gjendje të lejojë me lehtësi të modernizimit të mundshëm, duke përfshirë dispozita për tipe të reja të huave të obligacioneve, sipas tendencave ndërkombëtare dhe kërkesave të tregut vendor.

Ky ligj do të mundësojë krijimin e një tregu obligacionesh në vendin tonë, treg i cili është i nevojshëm për t’u dhënë mundësi shoqërive aksionare dhe njësisë të qeverisjes vendore që të rrisin nivelin e huasë, në kushtet kur sektori

bankar nuk ka mundësi të mbështesë më tej me kredi bankare. Funkcionimi i këtij tregu do të ndikojë në zgjerimin e tregjeve financiare që veprojnë në vendin tonë, ku norma e interesit të obligacioneve do të përcaktohet nga tregu, si dhe rritja e kapitalit dhe investimeve në ekonomi.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shtator 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-shtator, arritën shifrën 6,169,406 mijë lekë përkundrejt 5,395,411 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 14.35% më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 46.54% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 53.46% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 39.64 % të sigurimeve të Jetës dhe 12.42 % të sigurimeve të Jo-Jetës.


Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 91.37% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës.

Gjatë 9-mujorit të vitit 2009 u nënshkruan rreth 585,154 kontrata sigurimi, ose rreth 15.18% më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.

Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-shtator 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 53.46% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut

Struktura e tregut të sigurimeve, janar - shtator 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - shtator (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2008	2009
Periudha janar-shtator		
A) Sigurimi i Jetës	381,256	532,367
B) Sigurimi i Jo - Jetës	5,014,155	5,637,038
Nga këto		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	2,999,210	3,298,438
b) Sigurimi Vullnetar	2,014,945	2,338,600
TOTAL	5,395,411	6,169,406

të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, për 9 mujorin 2009, arritën 2,075,145 mijë lekë, ose 1.79% më shumë se në periudhën janar-shtator 2008.

Në janar-shtator 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 907,841 mijë lekë, ose rreth 28.69% më shumë se në periudhën janar-shtator 2008.


Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 9-mujorit 2009 arritën në 315,453 mijë lekë, apo

23.69% më shumë se në periudhën janar-shtator 2008.

Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar-shtator 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,870,967 mijë lekë, ose 19.81% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj kryesisht në infrastrukturë.

Volumi i primit të shkruar bruto, janar - shtator 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)




i aksidenteve dhe shëndetit si dhe sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-shtator 2009 arritën në 297,056 mijë lekë, ose 33.05% më shumë se në periudhën janar-shtator 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 76.71% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në 9-mujorin e vitit 2009 arritën në rreth 532,367 mijë lekë, ose rreth 39.64% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-shtator 2009 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-shtator 2009 (Jeta)



Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,338,600 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 28.11%, të pasuara nga sigurimi kasko me 20.02% dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 19.04 %, dhe peshë më të ulët patën sigurimi

lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet



ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.64% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-shtator 2009 kapi vlerën 1,212,300 mijë lekë, ose 11.55% më shumë se në janar-shtator të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 1,055,843 mijë lekë, apo 87.09% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me

13.21% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 9.28% krahasuar me periudhën janar-shtator të vitit 2008.


Risigurime

Gjatë periudhës janar-shtator 2009, janë lidhur kontrata risigurimi me vlerë mbi 71,444 mijë lekë, të cilat i përkasin sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko”

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2009

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë 9-mujorit të vitit 2009 u dominua në masën

Letra me vlerë të Qeverisë janar-shtator 2009



Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2008, 2009

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2008	2009	'09/'08-1
Periudha janar-shtator 2009			
Letra me vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	6,939.50	8,027.53	15.68
<i>Individë</i>	5,426.05	6,682.78	23.16
<i>Persona juridike</i>	1,513.45	1,344.75	(11.15)
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	398.81	1,673.71	319.67
<i>Individë</i>	385.65	771.31	100.00
<i>Persona juridike</i>	13.17	902.39	6,754.49

95.50% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 4.5% nga instrumente afatgjatë (obligacione).

Të dhënat statistikore të **tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë** për periudhën janar-shtator 2009, flasin për një dominim të transaksioneve “Shitje nga portofoli i bankës” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 33.58% dhe 32.30% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve individë apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individualë me 98.18% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë 9-mujorit të vitit 2009 ka pasur një rritje prej 1.08 miliardë lekë ose në masën 15.68% krahasuar me periudhën janar-shtator 2008, ndërsa numri i transaksioneve

ka pasur një rritje në masën 13.89%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë 9-mujorit të vitit 2009 ka pasur një rritje prej 1.27 miliardë lekë ose 319.67%, krahasuar me periudhën janar-shtator 2008, ndjekur nga një rritje në masën 65.35% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C me rreth 2.36 miliardë lekë.

Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar-shtator 2009


Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar-shtator 2009, shihet një rritje prej 36.50% e kontributeve dhe një rritje prej afër 14.83% e numrit të kontribuesve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008.




Tregu i pensioneve private vullnetare 2008, janar-shtator 2009 (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	2009		2008	2009
janar-shtator			'09/'08-1		
Raiffeisen PENSIONS	30,648,995	36,425,880	18.85	63.69	55.46
Capital	6,491,100	16,123,071	148.39	13.49	24.55
Sigma IPP	10,981,244	13,135,862	19.62	22.82	20.00
Total	48,121,339	65,684,813	36.50	100.00	100.00

Struktura e tregut të pensioneve private (sipas kontributeve)



Struktura e Tregut të Pensioneve Private (sipas numrit të kontribuesve)



Ngjarje dhe zhvillime të tjera Zhvillohet Konferenca e 16-të Vjetore e IAIS

IAIS, (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime) në bashkëpunim me SUSEP (Institucioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Brazil), zhvilluan gjatë periudhës 21-24 tetor 2009, në Rio de Janeiro, Brazil, Konferencën e 16-të Vjetore me temë: “Sigurimet si mjet i zhvillimit social-ekonomik, kriza financiare dhe e ardhmja e tregjeve të sigurimit”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kryesuar nga Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare, mori pjesë në këto mbledhje si anëtare me të drejta të plota e kësaj organizate.

Konferenca u ofroi mbikëqyrësve të sigurimeve dhe profesionistëve të fushës mundësi për të shkëmbyer ide dhe për të diskutuar mbi forcimin e mbikëqyrjes së tregjeve të sigurimeve.

Gjatë konferencës u ndërmorën një sërë hapash të rëndësishëm, ku bëjnë pjesë:

- Lançimi i iniciativës së aksesimit të sigurimeve, që përbën një qasje të re të bashkëpunimit ndërmjet agjencive ndërkombëtare të zhvillimit dhe mbikëqyrësve të sigurimeve. Qëllimi i iniciativës është forcimi i kapacitetit dhe ekspertizës së mbikëqyrësve të sigurimeve, si edhe lehtësimi i kontrollit të tregjeve.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit nga tre anëtarë të tjerë të Shoqatës. Marrëveshja lehtëson bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave midis mbikëqyrësve.
- Përshtatja e dokumentit udhëzues që përmban pikat kyçe të funksionimit të kolegjeve efektive të mbikëqyrjes së grupeve.
- Përfshirja në materialet trajnuese të Institutit të Stabilitetit Financiar (FSI) e çështjeve që kanë interes të veçantë për mbikëqyrësit e sigurimeve. Gjatë viteve të ardhshëm, FSI me mbështetjen e IAIS-it, do të prezantojë një sërë materialesh shtesë me temë sigurimet.
- Përshtatja e një udhëzimi standard mbi buri- met e kapitalit dhe aftësinë paguese, me synim përmirësimin e transparencës, krahasueshmërisë dhe konvergjencës në matjen e aftësisë paguese të siguruesve kudo në botë.

Në sesionet e paneleve të Konferencës së 16-të Vjetore, u diskutuan:

1. Sigurimet si një mjet i zhvillimit social-ekonomik

Paneli diskutoi mbështetjen financiare dhe nevojën për të nxitur biznesin e sigurimeve nëpërmjet politikave të suksesshme rregullatore

dhe mbikëqyrëse. Zhvillimi i sigurimeve në vende me të ardhura të ulëta ul ekspozimin kundrejt rreziqeve të papunësisë, sëmundjeve, vdekjes së të afërmeve, vjedhjeve, aksidenteve rrugore apo aksidenteve të ndodhura në punë. Tregjet e mikrosigurimeve ndryshojnë nga vendi në vend dhe ndryshimet mund të ndikojnë në qasje të ndryshme të zhvillimit dhe nxitjes së tregjeve.

Zhvillimi i tregut të mikrosigurimeve kushtëzohet nga mungesa e fuqisë blerëse, mungesa e kanaleve të shpërndarjes, kostot e larta të shitjes, kostot e larta të transaksioneve, etj. Thjeshtësia e produktit, praktikaliteti dhe kostot e ulëta përbëjnë çelësin e suksesit.

Lehtësirat e taksave u sugjeruan si një mjet për të nxitur zhvillimin e tregjeve të mikrosigurimeve. Të gjithë ranë dakord që qeveritë duhet të luajnë rolin e tyre në mbështetjen e zhvillimit të mikrosigurimeve dhe nxitjen e edukimit financiar me objektiv mbrojtjen e interesave të grupeve të popullatës me të ardhura të ulëta.

2. Mësimet nga kriza për mbikëqyrësit dhe industrinë e sigurimeve

Në shqyrtimin e mësimëve të nxjerra nga kriza, duhet bërë një dallim midis sektorit të sigurimeve dhe atij financiar. Paneli vlerësoi në veçanti se natyra sistematike e rrezikut tek sigurimet është e ndryshme nga ajo e sektorit bankar. Për rrjedhim, megjithëse ka shumë për të mësuar nga kriza e sektorit bankar, duhet treguar kujdes para se të ekstrapolohen dhe zbatohen masat e sektorit bankar tek sigurimet.

Kriza financiare ka treguar se duhen bërë përmirësime të mëtejshme në fushën e mbikëqyrjes së grupeve, investimeve,

kërkesave të kapitalit dhe likuiditetit, menaxhimit të krizës dhe strukturës e procesit të rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Disa masa të rëndësishme që duhen pasur parasysh janë: standardet e konvergjuara globale, bazat e forta të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes dhe kuadri global i mbikëqyrjes së grupeve. Masat e tjera mund të përfshijnë një këndvështrim të ri për administrimin e investimeve, përmirësimin e cilësisë së kapitalit, administrimin më të mirë të investimeve dhe riskut të likuiditetit dhe përgatitjen e mëtejshme për administrimin e krizës. Paneli konkludoi se është e rëndësishme të vijohet me reformat globale të rregullimit financiar, pavarësisht shenjave të përmirësimit ekonomik, duke pasur parasysh se kriza financiare globale mund të mos e ketë dhënë akoma efektin e saj përfundimtar.

3. *Një arkitekturë e re ndërkombëtare e mbikëqyrjes*

Panelistët diskutuan sesi kriza financiare ka nënvizuar rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe koordinimit të mbikëqyrjes së grupeve. U theksua nevoja për një rregullim dhe mbikëqyrje të fortë si në nivel kompanie, edhe në nivel grupi, ndërsa panelistët theksuan se janë të nevojshëm mekanizma të njëjtë të vlerësimit për të garantuar krahasueshmërinë dhe konsistencën nga vendi në vend. Në përmbledhjen e tij, Kryetari nënvizoi se me gjithë ndryshimet në përjasje dhe shpejtësi të reformave nga vende të ndryshme, mbikëqyrësit në botë bazohen në pika bazë të përbashkëta dhe kanë të njëjtat synime.

IAIS mund të luajë një rol jetësor në evidentimin e ndryshimeve të mbikëqyrjes dhe garantimin e një bashkëpunimi më të mirë të mbikëqyrësve.

4. *Nxitja e tregjeve të shëndosha të sigurimeve*

Paneli diskutoi elementët rregullatorë që duhen për të nxitur tregje të shëndoshë të sigurimeve. Diskutimet përfshinë pikat e forta dhe dobësitë e masave rregullative të ndërmarra gjatë krizës financiare, si edhe masat që duhet marrë në këndvështrim afatgjatë për të nxitur tregje të shëndosha të sigurimeve.

Elementët kryesorë për tregje të shëndosha të sigurimeve përfshijnë: një sistem ligjor të përshtatshëm, mbrojtje kundrejt mashtrimit, standarde të përshtatshme të kontabilitetit dhe një infrastrukturë të fortë të mbikëqyrjes. Qeverisja e kompanisë duhet të ketë orientim afatgjatë dhe fokusi të mos jetë thjesht fitimi i aksionarëve, por edhe mbrojtja e klientëve dhe publikut. Ka një nevojë të qartë dhe urgjente për bashkëpunim më të mirë midis mbikëqyrësve mbi bazë rajoni e më gjerë dhe një sjelljeje të koordinuar ndaj likuidimeve apo falimentimeve të shoqërive apo grupeve.

Dialogu shtet-privat është thelbësor në zhvillimin e praktikave të mbikëqyrjes. Në përgjithësi, modeli dhe kultura e biznesit tek sigurimet është konservatore dhe fokusohet në rreziqe afatgjata, çfarë ka rezultuar shumë pozitive gjatë krizës.

5. *Edukimi financiar dhe mbrojtja e konsumatorit*

Folësit në panel diskutuan çështje të lidhura me mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimet e mbikëqyrjes dhe vetë tregut. Nevoja për mbrojtjen e konsumatorit buron nga një mungesë ekuilibri në fuqinë, informacionin dhe burimet ndërmjet palëve të përfshira në transaksion.

Një çështje e njohur ishte ajo e këndvështrimit të mbrojtjes së konsumatorit të lidhur me sfidat e

garantimit të ligjeve, rregulloreve dhe praktikave në funksion të arritjes së objektivit të mbrojtjes së konsumatorit.

Krijimi i një sistemi të mirë për mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimin, shpeshherë është një proces i gjatë që mbikëqyrësit dhe siguruesit së bashku duhet ta shohin në evoluim të pandërprerë. Dhënia e informacionit dhe fakteve tek konsumatorët, i ndihmon ata të marrin vendime më të mira gjatë zgjedhjes së produktit dhe të kuptojnë se si funksionon produkti dhe kur nevojitet ai.

6. Zhvillimet globale në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes së aftësisë paguese

Panelistët paraqitën zhvillimet e fundit dhe përmirësimet e bëra në vendet e tyre në rregullimin e aftësisë paguese. U nënvizuan në mënyrë të veçantë: rëndësia e kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik, vlerësimi i aftësisë paguese në bazë grupi, vlerësimet aktuariale të provigjoneve teknike dhe testet profesionale të lidhura me to. Panelistët theksuan nevojën për të dalluar përfitimet dhe dobësitë e lidhura me përdorimin e modeleve të brendshme për qëllime të rregullimit dhe mbikëqyrjes.

7. Qeverisja e kompanisë dhe administrimi i riskut

Në panel u diskutuan çështje të qeverisjes së kompanisë dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut. Kriza e fundit financiare ka treguar rëndësinë e administrimit të rrezikut. Siguruesit duhet të marrin përsipër një masë të caktuar rreziku në kursin e biznesit të tyre, duke realizuar njëkohësisht edhe fitimin e tyre.

Mënyra sesi administrohet rreziku dhe kultura në lidhje me rrezikun dhe tolerancën ndaj tij, janë pika kyçe në qeverisjen e kompanisë. Praktikrat dhe strukturat e administrimit të rrezikut duhet t'u përshtaten mirë rreziqeve dhe sfidave që paraqet ambienti i biznesit. Punësimi i njerëzve me njohuritë e nevojshme që përmbush kriteret e përcaktuara të ekspertizës dhe etikës, është një çelës drejt qeverisjes së suksesshme. Përveç kësaj, politikrat e shpërblimeve nuk duhet të lejojnë bonuse të papërshtatshme, ndërsa është e rëndësishme të ruhet pavarësia e funksioneve të kontrollit.

8. Bashkëpunimi ndërmjet mbikëqyrësve

GBashkëpunimi efektiv i mbikëqyrësve merr një rëndësi të veçantë në kushtet e një biznesi ndërkufitar dhe ndër sektorial. Kriza financiare ka nënvizuar nevojën e mbikëqyrësve të sigurimeve për t'u bashkuar, si në rastin e mekanizmit të kolegjeve të mbikëqyrjes, për të shmangur ndonjë hapësirë në rregullimin dhe mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve.

Përpjekjet e IAIS-it për të mbështetur bashkëpunimin e mbikëqyrësve në nivel global, vlerësohen shumë të rëndësishme veçanërisht në përgjigjen që u jepet disa çështjeve që rrjedhin nga kriza financiare. Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit u përmend si një arritje e dukshme në drejtim të rritjes së bashkëpunimit.

Veprimtaritë e tjera në vijim që mbështesin objektivin e bashkëpunimit, lidhen me (i) iniciativat e hartimit të standardeve mbi bashkëpunimin ndërkufitar në menaxhimin e krizës, (ii) rezolutën e mbikëqyrjes së grupeve ndërkufitare dhe (iii) trajtimin e kompanive që nuk

përfshihen në rregullat e mbikëqyrjes së vendeve përkatëse. Në funksion të qëllimit të përbashkët të mbikëqyrjes efektive të grupeve, është e nevojshme nxitja e shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit midis mbikëqyrësve.

Së fundmi, besimi i ndërsjellë midis mbikëqyrësve të sigurimeve, është një parakusht i rëndësishëm në çdo formë të mekanizmave të bashkëpunimit.

Zhvillohet Takimi i Përgjithshëm Vjetor i IOPS dhe forumi global i OECD/IOPS për pensionet private “Reforma e pensioneve dhe zhvillime në Amerikën Latine”

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me OECD, zhvilluan në Rio de Janeiro, Brazil gjatë periudhës 14-16 tetor 2009, takimet e mëposhtme:

- a) Forumi global i OECD/IOPS për pensionet private “Reforma e pensioneve dhe zhvillime në Amerikën Latine”, 14-15 tetor 2009,
- b) Takimi i komiteteve teknike dhe ekzekutive të IOPS, 15-16 tetor 2009, si dhe
- c) Takimi i Përgjithshëm Vjetor i IOPS, 16 tetor 2009.

Qëllimi i forumit global ishte të shqyrtonte progresin e reformave dhe zhvillimet e reja në industrinë e fondeve të pensioneve në Brazil dhe në rajonin e Amerikës Latine, duke u fokusuar në sfidat kryesore që dalin përpara skemave individuale me kontribute të përcaktuara (DC) të menaxhuara privatisht-tipi kryesor i marrëveshjeve për pension në rajon, përfshirë

transferimin e riskut dhe dizenjimin e fazës së pagesës. Kështu, forumi global krijoi një mundësi, për të tërhequr eksperiencën ndërkombëtare, për të diskutuar iniciativat/politikat e reja të ndërtuara për të përmirësuar sistemet DC dhe shqyrtoi sfidat dhe avantazhet e promovimit të marrëveshjeve hibride të pensionit. Një sesion special iu kushtua strategjive të investimit të planeve private të pensioneve, ku gjetjet e studimeve të BB dhe OECD për matjen e performancës së investimeve, u paraqiten dhe u diskutuan rekomandime për politik bërësit.

Në forumin global të OECD dhe IOPS u diskutuan zbatimet dhe përgjigjet politike për krizën ekonomike dhe financiare në industrinë e pensioneve. Në fokus të veçantë ishin zhvillimet kryesore politike në industrinë braziliane të pensioneve.

Pjesëmarrësit nënvizuan avantazhet rregullative që Brazili ka bërë me “futjen në zbatim të një enti të konsoliduar rregullator” dhe “nivelin e lartë të përputhshmërisë me rekomandimet e OECD për Principet Bazë të Rregullimit të Pensioneve Profesionale”. Në këtë kontekst, përpjekjet për të krijuar një agjenci të pavarur rregullatore (PREVIC) përbën një hap të rëndësishëm në drejtimin e duhur. Pjesëmarrësit gjithashtu identifikuan “futjen e mbikëqyrjes mbi bazë risku si sfida kryesore për të ardhmen”.

Konferenca gjithashtu diskutoi mjaftueshmërinë e kursimeve dhe mbulimin, një përjasje të re në investimin sipas ciklit të jetës. Masat për të reduktuar paqëndrueshmërinë dhe nevoja për instrumente për të gjeneruar fleksibilitet më të lartë në fazën e pagesës u panë si sfida të mëdha.

Pjesëmarrësit gjithashtu diskutuan ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike në sistemin e pensioneve në rajonin e Amerikës Latine. Z. Pablo Antolin, ekspert në fushën e ekonomisë në OECD, komentoi që “Sistemet e pensioneve në Amerikën Latine kanë dalë më të fortë nga kriza. Përjasja ‘multi-fondos’ për investimet e aplikuar në shumicën e këtyre vendeve ka ofruar mbrojtje për investitorët vulnerabël afër moshës së pensionit. Qeveritë dhe rregullatorët e pensioneve i kanë rezistuar presionit për të nacionalizuar asetet e tyre të pensioneve. Me të vërtetë, ata kanë adoptuar përjasjen e kundërt-vazhdimin e ecjes përpara te reformës së sistemit të pensioneve private. P.sh, në Kili është aplikuar një masë e rëndësishme si futja e rrjetit të mbrojtjes sociale për të forcuar pensionet minimale.”. Përfaqësuesja e Kilit dhe ajo Perusë, nënvizuan “rëndësinë e kursimeve afatgjata për pension” dhe “fluktacionin a madh në vlerësim që kriza dhe tregjet e kapitalit të përmirësuar së fundmi kanë treguar”.

Përfaqësuesi i Nigerisë, në lidhje me mbulimin, shtoi se “për të arritur një nivel maksimal mbulimi duhet ta vendosim atë në kontekstin e shkallës së përgjithshme të zëvendësimit të sistemit të pensioneve, dhe rregullatorët e politikë-bërësit duhet të kuptojnë nevojat e njerëzve”.

Në përfundim, Z. Ross Jones tha: “dallimi midis marrëveshjeve me kontribute të përcaktuara dhe me përfitime të përcaktuara po e humbet kuptimin pasi të gjithë sistemet e pensioneve hasin të njëjtin tip risku. Përjasjet e reja për ndarjen e riskut po zhvillohen për të ndërtuar besimin në pensionet private”.

Në takim gjithashtu u paraqiten rezultatet

paraprake të projektit të OECD dhe BB për vlerësimin e performancës financiare të fondeve të pensioneve në botë.

Projekti - i lançuar nga BB dhe OECD në 2006, së bashku me tre partnerë të sektorit privat (bankat ndërkombëtare BBVA, ING dhe organizatën Holandeze të fondit të pensionit VB)-ka për qëllim të shqyrtojë si të masin performancën financiare të fondeve të pensioneve duke marrë në konsideratë lidhjen midis përfitimeve të anëtarëve me performancën e tregjeve financiare. Kriza financiare ka treguar paqëndrueshmërinë potenciale dhe paparashikueshmërinë e të ardhurave për pensione, të cilat mund të rezultojnë në rritjen e nevojës për të vendosur matës kuptimplotë të performancës që marrin ne shqyrtim fondet e pensioneve në relacion me aftësinë për të prodhuar një mënyrë efektive të zëvendësimit të të ardhurave në moshën e pensionit.

Megjithëse fondet e pensioneve kanë për qëllim të gjenerojnë të ardhura zëvendësuese me daljen në pension afatgjatë, ndërsa forma të tjera të investimeve kolektive janë kryesisht të interesuara në maksimalizimin e fitimit afatshkurtër, matësit e performancës që janë aplikuar zakonisht në fondet e pensioneve, janë identike me ato të përdorur për të vlerësuar performancën e tipeve të tjera të investimeve. Raporti nënvizoi që matësit e performancës duhet në fakt të fokusohen në afatgjatë.

Rekomandimet nga raporti, gjithashtu nënvizonin se politikë bërësit dhe rregullatorët mund të ndihmojnë fondet e pensioneve të adoptojnë strategji investimi, që jo vetëm marrin ne

konsideratë një perspektivë afatgjatë, por gjithashtu preferencat individuale dhe historikun e punës së anëtarëve/pjesëmarrësve. Portofolet e dizenuara me kujdes “cikël jete” mund të përdoren si krahasues nga mbikëqyrësit që përdorin sistemin e “semaforit” për të nënvizuar sesa lehtë fondet e pensioneve mund të aderojnë/aplikojnë në këto standarde.

Në takimin vjetor të IOPS u aprovuan një seri udhëzimesh dhe raporte të hartuara për të forcuar mbikëqyrjen e sistemeve globale të pensioneve dhe për të mbrojtur anëtarët vulnerabël të fondeve të pensioneve dhe pensionistët në kuadër të konditave ekonomike sfiduese dhe të ndryshueshme. Më poshtë jepen disa nga udhëzuesit dhe raportet e miratuara gjatë takimit.

Udhëzuesi i IOPS “Udhëzues për ndërhyrjen, sanksionet dhe detyrimin e mbikëqyrjes”, i cili nënvizon praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje me fuqinë e nevojshme që duhet përdorur nga autoritetet mbikëqyrëse në lidhje me ndërhyrjen, aplikimin e sanksioneve dhe detyrimin. Në të njëjtën mënyrë dokumenti “Kuadri i menaxhimit të riskut në fondet e pensioneve: Rregullimi dhe mbikëqyrja” i cili nënvizon tipin e sistemit të menaxhimit të riskut që autoritetet mbikëqyrëse presin në mënyrë që fondet e pensioneve të zbatohen, dhe mënyrat që mbikëqyrësit të verifikojnë që këto sisteme po operojnë në praktikë dhe jo në letër.

Me tej, duke ndjekur dështimet në mbikëqyrjen efektive në sistemin global financiar, anëtarët e IOPS po shikojnë veprimet dhe qeverisjen e tyre. Një material tjetër “Qeverisja dhe mekanizmat e performancës së autoriteteve mbikëqyrëse”

nënvizon si qeverisja e mirë e autoriteteve mbikëqyrëse mund të përmbledhet në katër kategori: pavarësi; përgjegjësi; transparencë dhe integritet.

Anëtarëve iu rekomandua të përdorin kombinime të mjeteve, prej krahasuesve sasiorë në anketimet e reputacionit dhe matjes së kostos.

E ardhmja e kuadrit rregullator financiar, roli i rregulloreve dhe enteve rregullatore të tregut

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), tetor 2009).

Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Letrave me Vlerë, zhvilloi në Bazel, Zvicër, gjatë periudhës 8-9 tetor 2009, Konferencën e 5-të, ku ndër të tjera u vu theksi në: rregullimin e efektshëm të tregjeve, i cili është jetik për qëndrueshmërinë financiare botërore; nevojën e identifikimit dhe kuptimit në kohë të rreziqeve, të lindura rishtazi në tregje dhe trajtimit të këtyre rreziqeve; kërkesën e një vullneti të fortë politik për t'i vënë në zbatim në nivel vendi idetë botërore.

Në daljen nga kriza, i rëndësishëm është rregullimi i efektshëm i institucioneve të rëndësishme. Për qëndrueshmërinë e sistemit kanë rëndësi institucionet dhe tregjet. Konfliktet e interesit, huadhënia dorëlëshuar, përdorimi i tepruar i borxheve, vlerësimet e gabuara, ndarja e borxhit në letra me vlerë të mbivlerësuara, zërat e mbajtur jashtë bilancit, kompensimi ekstrem, të gjitha kanë ndodhur në fushën e rregullimit apo mos rregullimit të tregut. Këto veprimtari mund të çojnë në sjellje dhe mekanizma të cilat



kanë rrjedhoja të përhershme. Me fjalë të tjera, për qëndrueshmërinë e sistemit kanë rëndësi institucionet dhe kanë rëndësi tregjet. Edhe institucioni më i përsosur dhe i rregulluar me kujdes do të fundoset, nëse tregjet në të cilat ushtron aktivitet janë tejte të paqëndrueshme dhe të parregulluara.

Të dy, edhe rregullimi i tregjeve dhe rregullimi i institucioneve të rëndësishme për sistemin, kanë rëndësi. Ata janë binjakët virtuoz të qëndrueshmërisë financiare dhe të dy duhet të ekzistojnë nëse duhen të evitohen problemet që sollën krizën.

Ndërkohë që zbutja e rrezikut të sistemit është parë në të shkuarën si njëri prej tre objektivave të rregullimit të letrave me vlerë, krahas nxitjes së tregjeve të efektshme dhe të drejta, mbrojtjes së investitorëve dhe disa parime të veçanta, kanë pasqyruar elemente të kësaj. Gjithashtu, është hedhur ideja se ka ardhur koha për ta shprehur si një parim të veçantë e të identifikuar qartë.

Puna kërkimore dhe identifikimi i rreziqeve të reja kanë rëndësi për sistemin. Ndërkohë që, zbutja e rrezikut të sistemit është parë në të shkuarën si njëri prej tre objektivave të rregullimit të letrave me vlerë, krahas nxitjes së tregjeve të efektshme dhe të drejtat e mbrojtjes së investitorëve.

Kriza financiare e ka përqendruar gjithë vëmendjen te rëndësia e trajtimit të rrezikut të sistemit dhe te roli i rëndësishëm që mund të luajnë tregjet dhe organet rregullatore të tregjeve në trajtimin e kësaj çështjeje. Parimi i ri IOSCO-s, do të përqendrohet te nevoja që entet rregullatore të tregjeve t'i identifikojnë, vlerësojnë dhe zbusin rreziqet brenda kufijve të tanishëm të rregullimit, madje edhe përtej tyre. Ky parim do të mbulojë edhe ato njësi ekonomike të rregulluara nga

entet rregullatore të tregjeve, dështimi i të cilëve mund të ketë rrjedhoja në sistem për të gjithë ekonominë.

Kryesor është vullneti politik. Mbledhja e fundit në Pitsburg e udhëheqësve të G20-ës pranoi edhe rolin që do të duhet të luajnë entet rregullatore të tregjeve të letrave me vlerë, në fushën e hartimit të qasjeve të reja globale për të identifikuar dhe administruar strukturat dhe produktet e reja në treg dhe për të identifikuar ato fusha të tregjeve në të cilat mund të lindin rreziqe për sistemin. Shkaqet e krizës ishin të shumta dhe të ndryshme dhe faji është shpërndarë në një spektër të madh strukturash.

Ashtu sikurse origjina e krizës qëndron në hipotezat e gabuara për fuqinë vetë rregulluese të tregjeve, po ashtu kjo origjinë qëndron edhe në mungesën e vullnetit politik për të rregulluar sjelljen e tregjeve. Tani ka ardhur koha që udhëheqësit e G20-ës dhe të tjerët të tregojnë vullnetin e nevojshëm politik, për të siguruar që standardet ndërkombëtare për tregjet e letrave me vlerë, të vendosur nga IOSCO, të vihen në zbatim në çdo vend të botës. Jo vetëm që duhen vënë në zbatim, por këto standarde duhet të kontrollohen ose të vlerësohen lidhur me respektimin e tyre e këto vlerësime duhet të publikohen.

Nocioni i fuqishëm i një ideje ndërkombëtare të vënë në zbatim në nivel kombëtar është çelësi për të ardhmen. Një botë e lidhur në rrjet, me standarde ndërkombëtare të fuqishëm të vënë në zbatim, do të ketë shumë rëndësi për t'u ruajtur nga kriza e radhës. Kapitali botëror kërkon rregullim dhe kontroll zbatimin botëror, e tani është ngritur infrastruktura kritike që të mundësojë këtë.

Si përfundim, tregjet kanë rëndësi për qëndrueshmërinë e sistemit. Është e nevojshme

të kuptohet më mirë sjellja e tregjeve dhe rreziqet e lindura rishtazi, të cilat mund të kenë rrjedhoja për sistemin dhe gjithashtu është po aq i nevojshëm vullneti politik i fuqishëm për të vënë në zbatim dhe për të kontrolluar standardet në mbarë botën, në mënyrë që të sigurohet një rrjet tregjesh të rregulluar në mënyrë të efektshme. Vetëm atëherë do të mund të arrihet objektivi, lidhur me një kuadër të ri financiar global për një rritje të fuqishme, të qëndrueshme dhe të ekuilibruar.

Zhvillohet Konferenca X-NET: “Pjesëmarrje efikase në tregjet financiare botërore”

Bursa e Athinës, zhvilloi më 26 tetor 2009, Athinë, Konferencën X-NET: “Pjesëmarrje efikase në tregjet financiare botërore”. Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i një platforme të re elektronike për shitje-blerjen e aksioneve të ofruara në tregjet financiare rajonale. Për të arritur këtë qëllim, Bursa e Athinës ka krijuar X-NET, një platformë elektronike, e cila mundëson lidhjet e ndërmjetësve të bursave (Broker-to-Broker), dhe rrjedhimisht lëvizjen e lirë të kapitalit dhe rritjen e likuiditetit. X-NET, fillimisht është shtrirë ndërmjet Bursës së Athinës (“ATHEX”) dhe Bursës së Qipros (“CSE”).

Një broker apo ndërmjetës ose agjent burse, duke u bërë pjesë e kësaj platforme, do të ketë mundësi për të marrë dhe ekzekutuar urdhra shitje-blerje nga investitorë internacionalë në bursën lokale. Këto transaksione mundësohen nga kontratat që kryen ndërmjet agjentëve të bursave që marrin pjesë në platformë respektivisht me njëri-tjetrin dhe me ATHEX/CSE. Në këtë mënyrë, agjentët e

bursave lokale do të kenë mundësi për të pasur vizibilitet në tregjet internacionale, duke përfutur edhe nga forca e reklamimit dhe marketingut të ATHEX/CSE. Agjentët e bursave, pasi është kryer transaksioni, ndajnë komisionet për urdhrat e ekzekutuara me ATHEX/CSE dhe agjentët e tjerë.

Platforma elektronike ishte e një niveli të lartë teknologjik dhe me potencial për të rritur aktivitetin, transparencën dhe likuiditetin e tregjeve financiare pjesëmarrëse. E rëndësishme është fakti se pjesëmarrja në këtë platformë për agjentin financiar është falas, (në bazë të një programi të OECD/DAC- Development and Assistantship Cooperation), dhe nuk është ekskluziv, pra agjenti është i lirë të marrë pjesë në platforma të tjera elektronike.

Përfaqësuesit nga AMF, bënë një prezantim gjatë zhvillimit të Konferencës, prezantim i cili u ndoq me mjaft interes nga pjesëmarrësit. Vendet që parashikohet të jenë anëtare të X-NET (përveç Greqisë dhe Qipros) janë Bullgaria, Rumania, Serbia, Bosnje Hercegovina, Jordania, Egjipti dhe Shqipëria. Platforma e tregtimit X-NET parashikohet të shtrihet në vendet e rajonit në tremujorin e parë të vitit 2010, ku vendet e para, anëtare të kësaj platforme, mendohet të jenë Rumania dhe Bullgaria.

Zhvillime të tjera

Gjatë muajit tetor u zhvilluan një sërë aktiviteteve të tjera:

- Ministria e Integritimit zhvilloi takimin mbi sfidat e ministrive të linjës dhe institucioneve

qendrore gjatë procesit të përgatitjes dhe hartimit të përgjigjeve të pyetësorit të Komisionit Evropian. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (1 prill 2009) dhe dorëzimit të kërkesës për antarësim në BE (28 prill 2009), Qeveria Shqiptare duhet t'i përgjigjet sfidave të reja për antarësimin e Shqipërisë në BE.

Në kuadër të aplikimit të Shqipërisë, në prill të këtij viti, për t'u bërë anëtare e Bashkimit

Evropian, është edhe përgjigja e pyetjeve të pyetësorit dhe përgatitja për negociatat për antarësim.

- Byroja Kombëtare e Sigurimeve Maqedoni, zhvilloi në Ohër, Konferencën e Parë Rajonale me temë "Situata dhe perspektiva e industrisë së sigurimeve në Rajon në kushtet e krizës botërore ekonomike". Gjatë konferencës u theksua, se zhvillimi i industrisë së sigurimeve në rajon, në të ardhmen është i paparashikueshëm, përderisa tregu i sigurimeve është treg sekondar, pra treg që ofron shërbim e për pasojë një aktivitet i ulët ekonomik nënkupton kërkesa më të vogla për produkte sigurimi.

Pjesëmarrja në këtë konferencë të parë i shërbeu shkëmbimit të eksperiencave, të informacionit apo të pikëpamjeve, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve, sidomos të tregut të sigurimit të jetës në rajon, forcimit të bashkëpunimit të vendeve të rajonit në fushën e sigurimit, zhvillimit dhe zbatimit të Direktivave të BE e standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

- Kompania kryesuese për këshillimet në fushën e burimeve njerëzore (BNJ) në Shqipëri (ACMS), së bashku me partnerin e saj GENESIS, kompani prestigjioze për këshillimet në fushën e burimeve njerëzore, zhvilluan në Tiranë Konferencën e Parë

Rajonale me temë "Pjesa njerëzore e menaxhimit". Gjatë konferencës u cilësua edhe themelimi i "Shoqatës Shqiptare të Burimeve Njerëzore" e cila do të ketë si fokus të saj qëndërzimin e të gjithë menaxherëve të BNJ të vendit për promovimin dhe shquarjen e këtij profesioni, së bashku me persona të tjerë që merrem me këtë fushë.

Temat e trajtuara gjatë seminarit, ishin: restrukturimi i një drejtimi sa më origjinal e të besueshëm të BNJ, BNJ në shoqëritë e shërbimeve; sjellja e menaxherëve shqiptarë në kushtet e reja të biznesit; komunikimi elektronik dhe BNJ; kontributi i CEO-s (chief executive officer - drejtori ekzekutiv) në aktivitetin e organizatës; menaxhimi i talentëve; sfidat dhe zgjidhjet; vlerësimi motivimi dhe trajnimet e punonjësve, strategjia e ndjekur dhe përmirësimet që duhen kryer, rasti i menaxhimit të BNJ pranë zyrës së Kryeministrit në Shqipëri, etj.

- Bursa e Turqisë në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë të Amerikës, (SEC) zhvilluan në Stamboll, programin mbi Ruajtjen e Integritetit të tregut në kohë të paqëndrueshme, mbikëqyrja, inspektimi dhe disiplinimi për rregullatorët e letrave me vlerë. Programi gjithashtu hodhi dritë mbi reagimet ndaj krizës dhe abuzimeve të tregut, duke dhënë observacione krahasuese nga sistemet rregullatore kudo në botë dhe duke vënë theksin në praktikat më të mira ndërkombëtare. Prezantuesit përdorën shembuj nga jeta reale të abuzimit të tregut, të paaftësisë së rregullatorëve, apo të organeve lokale për t'i zbuluar ato të cilat përbëjnë sfida reale për këto institucione. Ndër çështjet që u referuan përmendim: krizat e tregjeve të kapitalit, dhe rrënjët e saj; mbikëqyrja dhe disiplinimi i këtyre tregjeve; vështrimi i tregut

lidhur me këshilltarët e investimeve; manipulimet e tregut, mashtrimet dhe skemat, investigimet mbi çështjet kryesore; si dhe teknikat investigative dhe ekzaminimi i brokerave dhe ndërmjetësve, etj.

- Në Beatenberg, Zvicër, u zhvillua seminari mbi praktikën e avancuar në menaxhimin e riskut, në industrinë e sigurimeve. Temat e trajtuara, si: hyrje në menaxhimin e riskut; menaxhimi i riskut financiar dhe mësimi i fituar nga kriza financiare; menaxhimi i riskut për katastrofat natyrore (shoqëruar kjo edhe me skenare), etj., i përkisnin një niveli më të avancuar se ai i aplikuar në Shqipëri. Këto japin një paraqitje të përgjithshme të hapave dhe nevojave për një monitorim sa më të mirë dhe analitik të menaxhimit të riskut të tregut të sigurimeve.
- Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Zvicerane, zhvilluan në Bazël, takimin e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s.

Qëllimi i takimit ishte zgjerimi i mëtejshëm i rrethit të anëtarëve të Komitetit Rajonal Evropian, shkëmbimi i ideve të ndryshme lidhur me krizën financiare parë në këndvështrimin e mbikëqyrjes/rregullimit të tregut të Letrave me Vlerë, si dhe azhurnimi me zhvillimet më të fundit në juridiksionet respektive të anëtarëve të pranishëm.

- Në Mynih, Gjermani, u zhvillua konferenca e dytë vjetore për Tregun e Letrave me Vlerë. Konferenca u zhvillua, me qëllim që të sjellë së bashku praktikuesit dhe rregullatorët e industrisë për të marrë në konsideratë formën e mundshme për të ardhmen e rregullimit financiar, mbikëqyrjen e institucioneve financiare, si dhe stabilitetin dhe efikasitetin e sistemit financiar si një e tërë.
- Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO) zhvilloi në Madrid, programin e trajnimit për vlerësimin, investigimin, dhe mbrojtjen gjyqësore mbi tregtimin e brendshëm dhe çështjet e manipulimit të tregut në fushën e rregullimit të titujve.

Në seminar u diskutuan tema nga më të ndryshmet duke përfshirë: perspektiva e krizës së fundit



Gjatë zhvillimit të programit të trajnimit për vlerësimin, investigimin, dhe mbrojtjen gjyqësore mbi tregtimin e brendshëm dhe çështjet e manipulimit të tregut në fushën e rregullimit të titujve.

financiare; përdorimi i MMoU-së së IOSCO-s dhe teknikave investigative; ekzaminimi, mbledhja e provave dhe mbrojtja në gjyq e rasteve të tregut të brendshëm; manipulimi i tregut të titujve, llojet specifike, inspektimi dhe zgjidhja e rasteve të manipulimit të tregut dhe mbrojtja e konsumatorit.

Gjithashtu gjatë seminarit, u shqyrtuan dhe u bënë pesë studime në grup, të cilat kishin lidhje si me tregtimin e brendshëm, ashtu edhe me manipulimin e tregut të titujve.

- Në Ljubjanë u zhvillua takimi mbi mashtrimet në sigurime dhe përdorimit të produkteve të sigurimit për të pastruar paratë. Ndër pikat më të rëndësishme që u diskutuan përmendim: shtimin e ndërgjegjësimit për problemet në rritje të mashtrimit në sigurime dhe pastrimit të parave; propozimin e ideve rreth përgjigjeve efektive rregullatore në këto fusha; nxitjen e adoptimit të praktikave më të zgjedhura, si dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në procesin e mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve.

Edukimi i konsumatorit Përmirësohen gjatë vitit 2009 asetet e fondeve të pensioneve të vendeve OECD, si dhe raportet e financimit të tyre

(Material i nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS), tetor 2009.)

Në gjysmën e parë të vitit 2009, sistemet e fondëve të kapitalizuara në vendet e OECD, janë rimëkëmbur më shumë se 1.5 trilion\$ nga 5.4 trilion\$ në vlerë tregu që ato humbën në 2008 (nga 27.8 trilion USD në dhjetor 2007 në 22.4 trilion USD në dhjetor 2008). Fondet e pensioneve


të trajtuara veçmas përjetuan një kthim pozitiv mesatarisht me 3.5% në terma nominalë deri në qershor të këtij viti.

Në 2008, fondet e pensioneve të OECD, përjetuan një kthim negativ mesatarisht prej 21.4% në terma nominalë (24.1% në terma realë). Gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, fondet e pensioneve kanë rifituar një pjesë të humbjeve nga investimet, humbje të pësuar në 2008. Për vendet për të cilat ka informacion në dispozicion, mesatarisht, asetet e fondeve të pensioneve ishin, më 30 qershor 2009, 14% poshtë niveleve të tyre të dhjetorit 2007. Rimëkëmbja në performancën e fondeve të pensioneve ka vazhduar nga 30 shtatori 2009, duke u mbështetur në kthimet e qëndrueshme nga kapitali, por do të duhet dhe më tepër kohë përpara se humbjet e vitit 2008 të rikuperohen plotësisht.

Mesatarisht, fondet e pensioneve me performancën më të mirë ndërmjet tyre në vendet e OECD ishin ato në Norvegji dhe Turqi, me kthime nominale prej mbi 10%. Në anën tjetër, fondet e pensioneve në Shtetet e Bashkuara patën një kthim mesatar në terma nominal prej 4%, ndërsa fondet Australiane (superannuation) siguruan vetëm një kthim prej 1%.

Për fondet e pensioneve, rimëkëmbja e 2009 paraqet një hap të madh drejt shërimit të plagëve të shkaktuara nga plasja e dy flluskave të mëdha brenda të njëjtës dekadë. Për më tepër, kur matja bëhet për një periudhë të gjatë investimi të një fondi tipik pensionesh, performanca ka qenë e shëndetshme. Fokusimi në kthimin e një viti të vetëm, jep një pamje keqinformuese të aftësisë së fondeve të pensioneve, për të dhënë pensione të përshtatshme në moshë të thyer. Për shembull,

Figura 1. Norma nominale e kthimit nga investimet e fondeve të pensioneve në vendet e zgjedhura të OECD




Burimi: Statistikat globale mbi pensionet në OECD dhe vlerësimet e OECD

mesatarja e normës nominale të kthimit të fondeve të pensioneve gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit ishte 7.2% në Suedi (5.3% në terma realë) dhe 6.9% në Shtetet e Bashkuara (4.4% në terma realë).

Si rezultat i krizës, alokimet e kapitalit kanë rënë ndjeshëm. Ndërkohë që në dhjetor 2007 fondet e pensioneve në OECD investuan 50% në kapitale, në dhjetor 2009 kjo përqindje ra në 41%.

Ndikimi i krizës në kthimet nga investimet, ka



Burimi: Statistikat globale mbi pensionet në OECD dhe vlerësimet e OECD


Jashtë vendeve të OECD, fondet e pensioneve kanë shfaqur një rimëkëmbje akoma më të dukshme, edhe pse fondet e pensioneve në vende të tilla si Hong Kong (Kinë), Peru dhe Bullgari, patën kthime negative nga investimet me mbi 20% në terma nominalë në 2008. Ndërmjet janarit dhe qershorit 2009, kthimi mesatar nga investimet i fondeve të pensioneve në Hong Kong ishte 12% dhe në Peru ishte ndër më të lartët në botë me 18%. Vendet e tjera, të cilat kanë shfaqur një rimëkëmbje mbresëlënëse në performacë, janë Kili, Izraeli

dhe Pakistani. Në qershor 2009, si Kili ashtu dhe Pakistani rifituan nga humbjet e pësuar në 2008, ndërkohë që fondet e pensioneve në Izrael kanë rikuperuar plotësisht humbjet e tregut të përjetuara vitin e fundit. Eksperienca kundërshtuese ndërmjet vendeve të OECD dhe jo OECD është gjerësisht e drejtuar nga një rimëkëmbje e shpejtë e përjetuar nga tregjet në zhvillim. Disa vende jo OECD, si Egjipti dhe Ukraina, vuajtën pak nga kriza e 2008 për shkak të ekspozimit të tyre të lartë në bono thesari.

qenë i madh tek fondet e pensioneve në vendet ku kapitalet përfaqësojnë mbi një të tretën e aseteve totale të investuara. Këto vende gjithashtu kanë përjetuar rënien më drastike në alokimet e kapitalit. Në 2008, fondet e pensioneve Australiane ishin më shumë të ekspozuarat tek kapitalet, në

59% të aseteve totale, e ndjekur nga Irlanda (52%), Shtetet e Bashkuara (46%). Në krahasim, ekspozimi i kapitalit në 2007 ishte më i larti në Irlandë me 66%, e ndjekur nga Australia (61%) dhe Shtetet e Bashkuara (57%). Në vende të tjera, fondet e pensioneve kanë pasur përfitime nga të pasurit e një

Figura 2. Alokimi i aseteve të fondeve të pensioneve për kategori të caktuara investimesh në vendet e përzgjedhura të OECD, 2008. (Si përqindje e investimeve totale)



Burimi: Statistikat globale mbi pensionet në OECD

pjesë të madhe të asetëve të tyre të investuara në obligacione, normat e kthimit të të cilave tentojnë të jenë më të ulëta por më të qëndrueshme se ato të kapitaleve. Në dhjetor 2008, në 13 vende OECD, më tepër se 50% e asetëve ishin të investuara në obligacione (shiko figurën 2).

Ndryshimet në alokimin e asetëve ndërmjet 2007-2008, janë gjerësisht të drejtuara nga performanca relative e klasave të ndryshme të asetëve. Për më tepër, ka pasur disa ndryshime në alokimet e asetëve strategjike. Kjo është më e evidente në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Holandë, ku është e evidente që fondet e pensioneve me përfitim të përcaktuar janë duke reduktuar alokimin e tyre të targetuar në kapitale të listuara.

Një largim nga kapitalet është duke ndodhur gjithashtu në planet me kontribut të përcaktuar në disa vende në të cilat pjesëmarrësit mund të zgjedhin portofolet. Në vendet me sisteme detyruese, kthimet nga investimet raportohen çdo muaj ose çdo tre muaj, të cilat i kanë çuar disa pjesëmarrës të kalojnë në portofole me risk më të ulët. Si përqindje e të gjithë anëtarëve, gjithsesi, ata që kalojnë në portofole konservative, gjithsesi janë në numër të vogël, ndonëse përbëjnë një pjesë domethënëse (më pak se 10% në shumicën e vendeve).

Gjithashtu, gjatë dekadës së kaluar ka pasur disa zhvillime tek investimet, të vrojtuara si në fondet e pensioneve me përfitim të përcaktuar, ashtu dhe në fondet e pensioneve me kontribut të përcaktuar, të cilat shfaqen të jenë mbajtur dhe në disa raste më të intensifikuara si rezultat i krizës financiare.

· rritje e diversifikimit ndërkombëtar të portofoleve të kapitalit.

· rritje e përdorimit të derivativave për të mbrojtur si asetet ashtu dhe risqet e detyrimeve.

· vazhdim i ekspozimit ndaj klasave alternative të asetëve, duke përfshirë fondet e vetërregulluara (eng. hedge funds), kapitalin privat dhe infrastrukturën.

Një nga ekspozimet më të mëdha të asetëve ndërkombëtare është parë në fondet e pensioneve në Holandë. Një ekspozim i lartë në asete, të paraqitura në valuta të huaja, mbi një e katërta e asetëve totale, janë parë gjithashtu në vende të tjera si Hungari, Islandë, Japoni, dhe Zvicër.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, R. Eltari, E. Zalta, T. Cani, I. Jorgo, L. Rama, O. Zaçaj, E. Sherri, K. Myftari, D. Tahiraj, E. Beqir-Aga, E. Kokona